VENDIM
Nr. 261, datë 24.4.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR "PALLATI ME SHIGJETA – RRETHRROTULLIMI "SHQIPONJA""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 4, të vendimit nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë", zëvendësohen me "... nga buxheti i viti 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe